




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS



VENDIM


Për

**Dhënie ndihme të menjëhershme financiare familjes së Z.Metush Sinan Maldi për
dëmtim shtëpie nga zjarri, në fshatin Barbullush, Njësia Administrative Bushat,
Bashkia Vau Dejës
Nr. 41, datë 22. 07.2016**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr.8756 datë 26.03.2001 “Për emergjenat civile” i ndryshuar; Vendimit të Keshillit të Ministrave nr.329, date 16.05.2012 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare, per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore” paragrafi III, pika 1, germa a, b, e Udhezimi i perbashket Ministrise se Brendshme dhe Ministrise se Financave nr.263 date 24.05.2013 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare, per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore” ; Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ; Neni 62 i Kodit të Procedurave Administrative; Ligji Nr.147/2015 datë 17.12.2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, pas shqyrtimit të projekt-vendimit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Emergjencave Civile, Keshilli i Bashkisë Vau Dejës, në mbledhjen e datës 22.07.2016, me shumicë të cilësuar votash, për të përballuar dëmet e shkaktuara zjarri në banesën e z.Metush Maldi, fshati Barbullush, Njësia Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës me datë datë 27.06.2016, e vlerësuar nga specialistet e M.Z.SH-së (zjarrfikësve). Familja përbëhet nga 1 (një) person.

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare familjes së **z.Metush Sinan Maldi** të përbërë nga 1(një) anëtar, në shumën **10, 000 (dhjete mijë) lekë** për të përballuar dëmet e shtëpisë të shkaktuara nga rënia e zjarrit.
 - a. Burimi i financimit do të jetë fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2016
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Sektori i Emergjencave Civile.

- 
3. Ky vendim hyn ne fuqi sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 e Ligjit Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.
 4. U shpall sot me date 26/07/2016.

SEKRETARI
Gentian NDOJ



KRYETARI
Martin MARKU

